

Udhëzime për plotësimin e kërkesës për mbledhjen e
informacionit të nevojshëm për hartimin e planeve të
ndërhyrjes së jashtëzakonshme

(Version i rishikuar korrik 2019)

Kërkesat mbi mbledhjen e informacionit si dhe udhëzimet e trajtuara në këtë dokument, janë hartuar në zbatim të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”. Përmes formularëve të paraqitur në vijim, synohet të mblidhet informacion lidhur me qeverisjen dhe menaxhimin e bankës, veprimtaritë kryesore të saj, strukturën e pasiveve, kolateralet e vendosura, zërat jashtë bilancit, sistemet e përdorura nga banka për kryerjen e pagesave, klerimit dhe shlyerjes, sistemet e informacionit, ndërlidhjet dhe ndërvaresitë financiare dhe të tjera, si dhe marrëveshjet kontraktuale që mund të ndikojnë dhe ndikohen nga veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

1. Struktura dhe marrëveshjet

1.1. Struktura

Formularët standardë për mbledhjen e të dhënave ndahen në 9 kategori, si në vijim:

1. [Qeverisja dhe menaxhimi](#)
2. [Veprimtaritë kryesore](#)
3. [Struktura e pasiveve](#)
4. [Aktivet e barrësuara](#)
5. [Zërat jashtë bilancit](#)
6. [Sistemet e pagesave, kleringut dhe shlyerjes](#)
7. [Sistemet e informacionit](#)
8. [Ndërlidhjet](#) – (2 formularë)
9. [Marrëveshjet kontraktuale](#)

Informacioni mbi **strukturën organizative, funksionet me rëndësi kritike dhe kundërpalët e rëndësishme** është përfshirë në formularët e planeve të rimëkëmbjes, ndaj të dhënat përkatëse mblidhen nga informacioni i paraqitur në planet e rimëkëmbjes së bankave dhe nuk do të kërkohet edhe për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Gjithsesi, Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, ruan të drejtën të kërkojë detajime të mëtejshme të informacionit të mbledhur për të realizuar në mënyrë efektive procesin e hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe përditësimit të tyre, në bazë të ligjit nr. 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”.

1.2. Standardet kontabël

Bankat do të raportojnë vlerat e zërave në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit që përdoren për qëllime të raportimit financiar.

Shumat e raportuara në formularë duhet të paraqiten me vlerën e tyre bruto, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në udhëzim.

1.3. Numërimi

Në këto udhëzime, për t’ju referuar kolonave, rreshtave dhe qelizave të formularit, është ndjekur radha e mëposhtme:

1.4. Shkalla e zbatimit të këtij udhëzimi

Udhëzimi përgjithësisht zbatohet në nivelin e subjektit të licencuar në Shqipëri. Banka e Shqipërisë njofton shkallën e zbatimit të tyre me kërkesën përkatëse që u bëhet subjekteve.

1.5. Kodi identifikues LEI

Kodi i identifikimit ligjor të subjektit (LEI) është një kod alfa-numerik prej 20-karakteresh, i krijuar në bazë të standardit ISO 17442, të zhvilluar nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO). Ky kod mundëson identifikimin e qartë dhe unik të çdo personi juridik që është pjesë e një transaksioni financiar, në të gjitha juridiksionet ndërkombëtare. Me qëllim hartimin e ndërlidhjes së plotë të institucioneve që veprojnë në juridiksionin shqiptar

dhe atyre që veprojnë jashtë këtij juridiksioni, si dhe në kuadër të bashkëpunimit me autoritete kompetente të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të një shteti tjetër ose me organizata ndërkombëtare, të cilat janë përgjegjëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme ndaj një institucioni që është pjesë e një grupi bankar që vepron në Republikën e Shqipërisë, është mjaft e rëndësishme identifikimi i kodit LEI në formularët standartë të raportimit. Nëse subjekti raportues ose cdo subjekt tjetër për të cilin raportohet në formular, është i pajisur me kod LEI, raportimi në formularë do të realizohet **vetëm me këtë kod. Bankat duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për të identifikuar përmes kodit LEI subjektet për të cilat do të raportojnë.** Vetëm në rast se “kodi identifikues i subjektit - LEI” nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, subjektet, do të identifikohen me një kod unik, të tillë si NIPT¹. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me konotacionin “e padisponueshme”

Për më shumë informacion rreth këtij kodi identifikues, mund të vizitoni faqen <https://.GLEIF.org/en/about-lei/introducing-the-legal-entity-identifier-lei>.

¹ Për subjektet e regjistruara në Shqipëri, kodi identifikues përfaqësohet nga numri unik i identifikimit të shoqërisë, NIPT, i përbërë prej 10 karakteresh.

2. Udhëzime lidhur me formularët

ANEKSI I — QEVERISJA DHE MENAXHIMI

Ky formular, përfshin elementët e trajtuar në nenin 26, paragrafi 1, shkronja “a”, të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, në zbatim të nenit 12 (9) ligjit nr. 133/2016, si më poshtë:

- *vendndodhja, juridiksioni i veprimtarisë, licencimi dhe drejtuesit kryesorë për çdo subjekt juridik*

Në këtë formular raportohet vendndodhja, juridiksioni, praktikat licencuese dhe të drejtimit për bankën dhe subjektet e grupit bankar në Shqipëri dhe jo vetëm, duke paraqitur hierarkinë e plotë të strukturës së grupit me institucionet nga të cilat varet dhe ka në varësi banka e cila raporton.

Ky informacion duhet të plotësohet për të gjithë subjektet materiale të identifikuar në formularin për Aneksin I (p.sh. plani i rimëkëmbjes për subjektet materiale).

Në vijim të informacionit për subjektet materiale në Shqipëri, BSh kërkon informacion edhe për personin përgjegjes për dërgimin e informacionit mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në nivelin më të lartë të subjektit mëmë, me qëllim identifikimin e pikave të duhura të kontaktit për informacionin e marrë.

Udhëzime mbi kolonat specifike:

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| 010-020 | Subjekti juridik |
| 010 | Emri i subjektit |
| 020 | Kodi identifikues i subjektit Kodi LEI alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 010. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni financiar, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me konotacionin “e padisponueshme” |
| 030 | Vendndodhja Qyteti ku subjekti i listuar në kolonën 010 është regjistruar ligjërisht. |
| 040 | Juridiksioni përfundimtar Juridiksioni ku subjekti i kolonës 010 është përfshirë (inkorporuar), i identifikuar sipas ISO 3166. |
| 045 | Numri i zyrave/ degëve në një vendndodhje |
| 050 | Autoriteti licencues |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|--|
| | Emri i autoritetit që i ka dhënë subjektit të kolonës 010 licencën për të kryer veprimtari bankare dhe investimi. |
| 060 | Lloji i licencës |
| 070-090 | Drejtues kryesor Drejtuesi kryesor ose personi me vjetërsi më të lartë në subjekt , i cili është përgjegjës për dërgimin e informacionit të nevojshëm për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. |
| 070 | Emri Emër, Mbiemër |
| 080 | Numri i telefonit |
| 090 | Adresa e e-mailit |
| 100-140 | Drejtuesi përgjegjës për raportimin Punonjësi i nivelit të ulët të drejtimit ose me vjetërsi më të lartë në subjekt, i cili ka përgjegjësinë operationale për dhënien e informacionit të nevojshëm për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. |
| 100 | Emri Emër, Mbiemër |
| 110 | Funksioni |
| 120 | Departamenti |
| 130 | Numri i telefonit Numri i telefonit të departamentit dhe numri i telefonit të personit të përmendur në kolonën 100. |
| 140 | Adresa e e-mailit Adresa e departamentit dhe adresa e personit të përmendur në kolonën 100. |

ANEKSI II — VEPRIMTARITË KRYESORE

Ky formular, përfshin elementët e trajtuar në nenin nenin 26, paragrafi 1, shkronja “b”, të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, në zbatim të nenit 12 (9) ligjit nr. 133/2016, si më poshtë:

- *shpërndarjen e veprimtarive kryesore duke përfshirë ekspozimet dhe detyrimet kryesore sipas llojit të veprimtarisë, për çdo subjekt juridik,*
- *drejtuesi kryesor përgjegjës për planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës si dhe, nëse janë të ndryshëm, personat përgjegjës për subjektet e tjera juridike dhe veprimtaritë e tjera kryesore.*

Ky formular duhet të plotësohet vetëm për veprimtaritë që janë evidentuar si “kryesore” në planet e rimëkëmbjes.

Udhëzime lidhur me kolonat specifike:

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| 010 | Veprimtaritë kryesore Nënkupton “veprimtaritë kryesore” sipas nenit 4(48) të ligjit nr. 133/2016. |
| 030-040 | Subjekti juridik |
| 030 | Emri i subjektit |
| 040 | Kodi identifikues i subjektit Kodi LEI alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 030. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme” |
| 070-090 | Aktivet Aktivet totale për një veprimtari kryesore. Shuma e të gjithë llojeve të aktiveve për të gjitha monedhat duhet të jetë e barabartë me shumën e raportuar në formularët e planeve të rimëkëmbjes për veprimtaritë kryesore. |
| 070 | Lloji Me qëllim që të dallohen “huatë” nga “paradhëniet” (në mënyrë të veçantë huatë ndaj klientëve dhe ato ndaj institucioneve financiare), investimet (bono thesari, aksione dhe instrumente të ngjashme) si dhe aktive të tjera sipas rastit |
| 080 | Shuma Në milionë LEK. Në rastet kur monedha e origjinës nuk është LEK, vlera duhet të konvertohet në LEK duke përdorur kursin e këmbimit në datën e |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|--|
| | raportimit. |
| 090 | Monedha E përcaktuar sipas ISO 4217. Këtu do të trajtohet monedha e origjinës së aktivitetit. |
| 100-120 | Detyrimet Detyrimet totale për veprimtarinë kryesore. Shuma e të gjithë llojeve të detyrimeve për të gjitha monedhat duhet të jetë e barabartë me shumën e raportuar në formularët e planeve të rimëkëmbjes për veprimtaritë kryesore. |
| 100 | Lloji Me qëllim që të dallohen depozitat (në mënyrë të veçantë depozitat e klientëve nga ato bankare) dhe emetimet e titujve të borxhit sipas rastit. |
| 110 | Shuma Në milion LEK. Në rastet kur monedha e origjinës nuk është LEK, vlera duhet të konvertohet në LEK duke përdorur kursin e ditës së raportimit. |
| 120 | Monedha E përcaktuar sipas ISO 4217. Këtu trajtohet monedha e origjinës e detyrimit. |
| 130-170 | Drejtuesi kryesor Drejtuesin e nivelit të ulët ose personin me vjetërsi më të lartë në subjekt, i cili ka përgjegjësinë operacionale për dhënien e informacionit të nevojshëm për planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.. |
| 130 | Emri Emër, Mbiemër |
| 140 | Funksioni |
| 150 | Departamenti |
| 160 | Numri i telefonit Numri i telefonit të departamentit dhe numri i telefonit të personit të përmendur në kolonën 130. |
| 170 | Adresa e e-mailit Adresa e departamentit dhe adresa e personit të përmendur në kolonën 130. |

ANEKSI III —STRUKTURA E PASIVEVE

Ky formular përfshin elementët e trajtuar në nenin 26, paragrafi 1, shkronja “c”, të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, në zbatim të nenit 12 (9) ligjit nr. 133/2016 , si më poshtë:

- *Një përshkrim të detajuar të përbërësve të detyrimeve të subjektit dhe të njësive përbërëse, të ndara minimalisht sipas llojit dhe shumës në borxh afatshkurtër dhe afatgjatë, të siguruar ose jo dhe borxh të varur.*
- *Detaje mbi ato detyrime të subjektit që janë detyrime të pranuar për qëllime të rikapitalizimit nga brenda.*

Udhëzime lidhur me plotësimin e rreshtave specifike:

Të gjitha kategoritë janë përjashtuese të njëra- tjetrës, që nënkupton se asnjë instrument apo vlerë nuk mund të raportohet në më shumë se një rresht të tabelës.

| Rreshti | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|--|
| 100-190 | Detyrime që përjashtohen nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda Këtu përfshihen të gjitha detyrimet që përjashtohen nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda, i trajtuar në nenin 31 (2) të ligjit nr. 133/2016. |
| 100 | Totali i detyrimeve të përjashtuara nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda $100 = 110 + 120 + 130 + 140 + 150 + 160 + 170 + 180 + 190$ |
| 110 | Depozitat e siguruar Detyrimet që rrjedhin nga depozitat e siguruar, deri në shumën maksimale të mbuluar sipas ligjit nr 53/2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar. Këto të fundit, përjashtohen nga objekti i instrumentit të rikapitalizimit nga brenda sipas nenit 31 (2) (a) të ligjit nr 133/2016. |
| 120 | Detyrimet e siguruar Detyrimet e siguruar me hipotekë, peng, barrë siguroese, kolateral financiar ose të drejtat reale të ngjashme, duke përfshirë veprimet repo, obligacionet e garantuara dhe detyrimet në formën e instrumenteve financiare të përdorura për qëllime mbrojtjeje (<i>hedging</i>). Këto të fundit përjashtohen nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda sipas nenit 31 (2) (b) të ligjit nr. 133/2016. |
| 130 | Detyrimet e klientit Detyrimet që rrjedhin nga administrimi i aktiveve të klientëve, të mbajtura për llogari të një fondi investimesh ose fondi pensionesh nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Këto detyrime përjashtohen nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda sipas nenit 31 (2)(b) të ligjit nr. 133/2016. |
| 140 | Detyrimet e subjektit (bankës) < 7 ditë Detyrime ndaj bankave vendase ose të huaja dhe shoqërive të investimeve, me një afat maturimi fillestar prej më pak se shtatë ditësh, duke përjashtuar subjektet që janë pjesë e të njëjtit grup bankar. Këto detyrime përjashtohen |

| Rreshti | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| | nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda në përputhje me nenin 31(2) (ç) të ligjit nr. 133/2016. |
| 150 | Detyrimet ndaj sistemeve të pagesave < 7 ditë Përfshihen detyrimet ndaj sistemeve të pagesave, të klerimit dhe shlyerjes me maturim të mbetur më pak se 7 ditor, të cilat përmbushin specifikat e ligjit nr. 133/2013 “Për sistemet e pagesave”, si sisteme dhe /ose operatorë të rëndësishëm të pjesëmarrësve në këto sisteme dhe që lindin nga këto sisteme. Këto detyrime përjashtohen nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda në përputhje me nenin 31 (2) (d) të ligjit nr.133/2016. |
| 160 | Detyrimet ndaj punëmarrësve Detyrime ndaj punëmarrësve që rrjedhin nga paga, pensioni ose çdo shpërblim tjetër fiks, të maturuara dhe të papaguara, me përjashtim të pjesës së pagës që lidhet me kontributin e punëmarrësit në suksesin e aktivitetit të punëdhënësit (shpërblime, bonuse etj.) dhe të përbërësve të tjerë variabël të shpërblimit; Këto detyrime përjashtohen nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda sipas nenit 31 (2) (dh) të ligjit nr. 133/2016. |
| 170 | Detyrimet ndaj kreditorëve Detyrimet ndaj kreditorëve që kanë shitur produkte ose i kanë ofruar shërbime bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, të cilat janë të domosdoshme për vazhdimin e aktivitetit të përditshëm, duke përfshirë shërbimet e teknologjisë së informacionit, shërbimet utilitare dhe ato të mirëmbajtjes e marrjes me qira të ambienteve. Këto detyrime përjashtohen nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda në përputhje me nenin 31(2)(e) të ligjit Nr. 133/2016. |
| 180 | Detyrimet tatimore dhe të lidhura me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore Përfshihen detyrimet e lidhura me tatimet dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore. Këto detyrime përjashtohen nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda sipas nenit 31(2)(ë) të ligjit Nr. 133/2016. |
| 190 | Detyrimet ndaj ASD Detyrimet ndaj Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe kontributi për “Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, përjashtohen nga instrumenti I rikapitalizimit nga brenda sipas nenit 31(2)(f) të ligjit Nr. 133/2016. |
| 200-270 | Detyrime që nuk përjashtohen nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda |
| 200 | Totali i detyrimeve që nuk përjashtohen nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda $200 = 210 + 220 + 231 + 240 + 250 + 260 + 270 + 280$ |
| 210 | Depozitat e pasiguruara Depozitat që nuk kualifikohen për t’u përjashtuar nga instrumenti i rikapitalizimit nga brenda si më sipër. Shuma totale duhet të ndahet sipas |

| Rreshti | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| | afatit të mbetur të maturimit në “më pak se 1 vit” dhe në “më shumë se një vit” sipas rreshtave në vijim. |
| 211 | <i>Nga të cilat: Maturimi i mbetur < 1 vit</i> |
| 212 | <i>Maturimi i mbetur ≥ 1 vit</i> |
| 220 | <p>Vlera e tregut për detyrimet nga derivativet</p> <p>Në këtë zë do të raportohen detyrimet që rrjedhin nga kontratat derivative në bazë të vlerës së tregut të tyre, duke njohur plotësisht të drejtat për kompensim të palës tjetër. Në rast se banka raporton se ky zë ka vlerën zero duhet të qartësohet përmes një komenti specifik në fushën përkatëse në formular nëse: a. Banka nuk zotëron produkte derivative b. Shuma e pozicionit neto të produkteve që zotëron banka, është në krahun e aktivitetit dhe jo te pasivitetit.</p> |
| 221 | <p>Shuma e pozicioneve neto të derivativeve sipas rregullave prudenciale të netimit</p> <p>Pozicioni neto i detyrimit në përputhje me rregullat prudenciale të netimit duhet të raportohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në kreun IV të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, nr. 48, datë 31.07.2013, e ndryshuar.</p> |
| 230 | <p>Dëftesat e strukturuar</p> <p>Dëftesat e strukturuar përkufizohen si detyrime të borxhit që përmbajnë një përbërës derivativ, kthimi i të cilit varet nga një titull ose indeks (publik ose me ofertë, si aksione ose obligacione, me norma fikse kthimi ose të kredisë, të monedhave, mallrave kryesore, etj). Dëftesat e strukturuar nuk përfshijnë instrumente të borxhit që mbartin vetëm opsionin e shitjes ose të blerjes p.sh. vlera e instrumentit nuk varet nga ndonjë element përbërës i derivativit që e mbulon. Shuma totale duhet të ndahet sipas afatit të mbetur të maturimit në “më pak se 1 vit” dhe në “më shumë se një vit” sipas rreshtave në vijim</p> |
| 231 | <i>Maturimi i mbetur < 1 vit</i> |
| 232 | <i>Maturimi i mbetur ≥ 1 vit</i> |
| 240 | <p>Detyrimet e pagarantuar</p> <p>Këtu do të trajtohen të gjithë instrumentet që paguhen të parët dhe që nuk janë përfshirë në kategorinë e dëftesave të strukturuar. Shuma totale duhet të ndahet sipas afatit të mbetur të maturimit në “më pak se 1 vit” dhe në “më shumë se një vit” sipas rreshtave në vijim.</p> |
| 241 | <i>Maturimi i mbetur < 1 vit</i> |
| 242 | <i>Maturimi i mbetur ≥ 1 vit</i> |
| 250 | <p>Detyrimet e borxhit të varur (të pakklasifikuara si pjesë e kapitalit rregullator)</p> <p>Në përgjithësi, borxhi i varur përfshin detyrimet që do të paguhen vetëm në zbatim të ligjit kombëtar të likuidimit pasi janë likuiduar plotësisht të gjitha klasat e kreditorëve të zakonshëm. Këtu përfshihen detyrimet e varura</p> |

| Rreshti | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| | <p>kontraktuale dhe statutore. Në rastin e shoqërive që janë pjesë e një grupi (<i>holding companies</i>), kjo kategori mund të përfshijë edhe instrumente të titujve të borxhit që ende nuk janë klasifikuar si “të varura” (p.sh. varësia strukturore).</p> <p>Në këtë kategori përfshihen instrumentet e borxhit të varur që nuk janë klasifikuar si elementë të kapitalit rregullator. Me qëllim që të garantojë rikonsilimin e të gjithë shumave përbërëse të detyrimeve, kjo kategori duhet të trajtojë detyrimet e varura që klasifikohen si “kapital rregullator”, për pjesën që nuk është përfshirë në kapital si pasojë e maturimit të tyre (phase-out) psh. si rrjedhojë e rregullave të vjetërimit të tyre apo të faktit që mbartin maturitet të mbetur më të ulët se 5 vjet. Si shembull, një instrument i përfshirë në Kapitalin e Nivelit të Dytë, me maturim të mbetur prej 3 vitesh në datën e raportimit duhet të përfshihet në shumën e tepicës së kapitalit të nivelit të dytë me 3/5 e tij dhe pjesa e mbetur prej 2/5 do të raportohet në kategorinë e borxhit të varur. Shuma totale duhet të ndahet sipas afatit të mbetur të maturimit në “më pak se 1 vit” dhe në “më shumë se një vit” sipas rreshtave në vijim.</p> |
| 251 | Maturimi i mbetur < 1 vit |
| 252 | Maturimi i mbetur ≥ 1 vit |
| 260 | <p>Detyrimet jo-financiare</p> <p>Në këtë rresht përfshihen detyrimet jo-financiare që nuk janë të lidhura me instrumentet e borxhit, mbajtësit e të cilëve, për arsye praktike, do t'i nënshtrohen rikapitalizimit nga brenda. Shembull i këtyre detyrimeve janë provigjonet e lidhura me pretendimet, subjekt i të cilave është subjekti raportues (p.sh. pretendimi varet nga ngjarje të ardhshme, procedura gjyqësore në këtë rast, dhe nuk mund t'i nënshtrohet rikapitalizimit nga brenda, në rast se banka nuk është më funksionale sikurse llojet e tjera të provigjioneve në bilanc).</p> |
| 270 | <p>Detyrimet e mbetura</p> <p>Kjo është një kategori me shuma të mbetura. Për rrjedhojë, në këtë rresht, pritet të vendosen shuma jodomethënëse; megjithatë, ky rresht mund të përdoret si rikonsilues i shumës së detyrimeve të vendosura në këtë formular me ato të publikuara në pasqyrat financiare.</p> |
| 300-330 | <p>Kapitali</p> <p>Kapitali rregullator i subjektit raportues.</p> |
| 300 | <p>Kapitali rregullator total</p> <p>300 = 310 + 320 + 330</p> |
| 310 | <p>Kapitali bazë i nivelit të parë</p> <p>Subjektet duhet të raportojnë kapitalin bazë të nivelit të parë sipas përcaktimit të nenit 6 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës” nr. 69, datë 18.12.2014, e ndryshuar.</p> |
| 320 | Kapitali shtesë i nivelit të parë |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Rreshti | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| | Subjektet duhet të raportojnë kapitalin shtesë të nivelit të parë sipas përcaktimit të nenit 21 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës nr. 69, datë 18.12.2014, e ndryshuar. |
| 330 | Kapitali i nivelit të dytë Subjektet duhet të raportojnë kapitalin e nivelit të dytë sipas përcaktimit të nenit 30 të rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës” bankës nr. 69, datë 18.12.2014, e ndryshuar. |
| 400 | Detyrimet totale dhe kapitali rregullator përfshi detyrimet derivative Ky rresht duhet të jetë shuma e të gjitha detyrimeve të raportuara në këtë formular, së bashku me shumën e kapitalit rregullator. Përsa i përket derivativeve, vlera e përdorur do të jetë ajo e raportuar në rreshtin 221 “shuma e detyrimeve neto duke konsideruar rregullat prudenciale të netimit”. $400 = 100 + 200 + 300$ |
| 500 | Kapitali total Vlera e raportuar në këtë rresht duhet të jetë sa shuma e kapitalit të raportuar në bilanc. |
| 600 | Aktivet totale Kjo vlerë duhet të jetë sa totali i aktiveve të raportuara në bilanc. |

Udhëzime lidhur me kolonat specifike:

Të gjitha kategoritë janë përjashtuese të njëra tjetrës, që nënkupton se asnjë instrument apo vlerë nuk duhet të raportohet në më shumë se një kolonë të formularit. Në përgjithësi të gjitha detyrimet e rregulluara nga ligji shqiptar/të emetuara nga subjektet në Shqipëri, duhet të ndahen në kategori të përfshira në kolonat 010 deri në 090, ndërsa detyrimet e parregulluara nga legjislacioni shqiptar/të paometuara nga subjektet shqiptare duhet të shpërndahen përkatësisht në kolonat 100 dhe 110.

| Rreshti | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| 010 | Personat fizikë |
| 020 | Ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme |
| 030 | Shoqëritë e mëdha jo-financiare Në këtë ndarje duhet të raportohet çdo shoqëri që nuk mbulohet nga kategoritë e tjera. |
| 040 | Institucionet Sikurse përcaktohet në nenin 4 të rregullores nr. 48, datë 31.07.2013, e ndryshuar “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, me përjashtim të subjekteve brenda grupit të cilat janë raportuar në kolonën 070. |
| 050 | Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Rreshti | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|--|
| | Shoqëritë e sigurimit, risigurimit dhe fondet e pensionit. |
| 060 | Institucione të tjera financiare Kundërpartitë e përcaktuara në nenin 4 të rregullores nr. 48, datë 31.07.2013, e ndryshuar “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, me përjashtim të subjekteve të raportuara në kolonat 040 and 050. |
| 070 | Ekspozimet brenda grupit Ekspozimet kundrejt subjekteve që janë pjesë e të njëjtit grup. Këto ekspozime duhet të listohen në këtë rresht në mënyrë që të shmanget llogaritja e dyfishtë e tyre (p.sh. ekspozimet ndaj një banke që është pjesë e të njëjtit grup duhe të identifikohen në rreshtin 110 dhe jo në rreshtin 080 tek “institucionet kredidhënëse”). |
| 080 | Qeveria, bankat qendrore dhe organizatat shumëkombëshe Kundërpartitë shumëkombëshe përfshijnë organizatat shumëkombëshe |
| 090 | Të tjera / të paidentifikuara Në rastet kur identiteti i mbajtësit të një titulli nuk dihet, shumat duhet të raportohen në këtë kolone dhe nuk kërkohet detajim i mëtejshëm. Për çdo rast duhet të bëhen përpjekje maksimale për të identifikuar kundërpartitë dhe të kufizohet sa më shumë përdorimi i kësaj kolone. |
| 100 | Instrumente të emetuara sipas legjislacionit të BE dhe ZEE Këtu përfshihet shuma bruto e të gjithë detyrimeve të rregulluara nga ligjet e BE/ZEE ose të emetuara nga subjekte të grupit të themeluara në BE/ZEE. |
| 110 | Instrumente që nuk janë emetuar sipas legjislacionit të BE dhe ZEE Këtu përfshihet shuma bruto e të gjithë detyrimeve që nuk janë rregulluar nga legjislacioni i një shteti të BE/ZEE ose të emetuara nga subjekte të grupit që nuk janë themeluar në BE/ZEE. |
| 120 | Totali $120 = 010 + 020 + 030 + 040 + 050 + 060 + 070 + 080 + 090 + 100 + 110$ |

ANEKSI IV — AKTIVE TË BARRËSUARA

Ky formular, përfshin elementët e trajtuar në nenin nenin 26, paragrafi 1, shkronja “d”, të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, “Për planet e ndërhyrjes së Jashtëzakonshme” në zbatim të nenit 12 (9) ligjit nr. 133/2016, si më poshtë:

- *Një identifikim të proceseve të nevojshme për të përcaktuar palët ndaj të cilave subjekti ka vendosur aktivet të barrësuara (aktive të bankës të lëna kolateral), mbajtësin e kolateralit dhe juridiksionin e vendit ku është vendosur kolaterali.*

Udhëzime lidhur me kolonat specifike:

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| 010-020 | Subjekti juridik |
| 010 | Emri i subjektit |
| 020 | Kodi identifikues i subjektit Kodi LEI alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 010. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”. |
| 030-040 | Emetuesi i kolateralit |
| 030 | Emri i subjektit |
| 040 | Kodi identifikues i subjektit Kodi LEI alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 030. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, një formë tjetër identifikimi duhet të mundësohet. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”. |
| 050 | Lloji i kolateralit Mbulon të gjithë llojet e garancive duke përfshirë rastet e detyrimeve jashtë bilancit apo ato për të cilat nuk ka asnjë detyrim (p.sh. <i>sap</i> -et e kolateraleve, fondet e zakonshme të pensionit). |
| 060 | Numri identifikues Kodi ISIN. Në rastet kur “Kodi ISIN” nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm për rastet kur nuk ka një formë tjetër identifikimi, lejohet plotësimi me “e |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|--|
| | padisponueshme”. Në rastet kur kolaterali është <i>cash</i> , duhet të përdoret kategoria: “e paaplikueshme”. |
| 070-080 | Mbajtësi i kolateralit |
| 070 | Emri i subjektit |
| 080 | <p>Kodi identifikues i subjektit</p> <p>Kodi alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 070. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion.</p> <p>Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”</p> |
| 090 | <p>Shuma</p> <p>Shuma e kolateralit në monedhën e raportuar në rreshtin 100. Shumat duhet të paraqiten në milionë sipas njësive të përdorura në formularët e tjerë.</p> |
| 100 | <p>Monedha</p> <p>E përcaktuar sipas ISO 4217</p> |
| 110 | <p>Juridiksioni</p> <p>Legjislacioni i juridiksionit të aplikueshëm për mbajtësin e kolateralit i identifikuar në kolonën 070 (p.sh. legjislacioni gjerman).</p> |

ANEKSI V — ZËRAT JASHTË BILANCIT

Ky formular, përfshin elementët e trajtuar në nenin nenin 26, paragrafi 1, shkronja “b”, të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, në zbatim të nenit 12 (9) ligjit nr. 133/2016, si më poshtë:

- një përshkrim të ekspozimeve jashtë bilancit të bankës, duke përfshirë një shpërndarjen e tyre sipas veprimtarive kryesore dhe shërbimeve kritike
- informacion lidhur me shërbimet jashtë bilancit dhe strategjitë e mbrojtjes

Për aktivet jashtë bilancit, në këtë formular, do të raportohen vetëm zërat jashtë bilancit që janë subjekt i faktorëve të konvertimit të kredisë. Derivatvët nuk duhet të përfshihen. Gjithashtu, edhe për detyrimet jashtë bilancit, në këtë formular nuk do të përfshihen derivativët.

Bankat duhet të raportojnë në baza individuale të gjitha ekspozimet jashtë bilancit të lidhura me funksionet kritike deri në 75% të vlerës së ekspozimit total për këtë funksion. Pjesa e mbetur e ekspozimit të këtij funksioni duhet të përfshihet si një shumë totale që i përket subjekteve të përcaktuara si “të tjera”.

Udhëzime lidhur me kolonat specifike:

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| 010-020 | Subjekti juridik |
| 010 | Emri i subjektit |
| 020 | Kodi identifikues i subjektit Kodi LEI alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 010. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme” |
| 030 | Aktivet jashtë bilancit Të identifikohet si një nga kategoritë në vijim: “garanci”, “linjë kredie”, “të tjera”. Kjo kolonë nuk duhet të përfshijë zëra të bilancit dhe derivative. |
| 035 | Detyrimet jashtë bilancit Të identifikohet si një nga kategoritë në vijim: “garanci”, “linjë kredie”, “të tjera”. Ashtu si për aktivet, kjo kolonë nuk duhet të përfshijë zëra të bilancit dhe derivative. |
| 040-050 | Kundërpartia |
| 040 | Emri i subjektit |
| 050 | Kodi identifikues i subjektit Kodi LEI alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 040. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| | <p>subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion.</p> <p>Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”.</p> |
| 060-070 | Shuma |
| 060 | <p>Totali</p> <p>Vlera nominale në milionë LEK.</p> |
| 070 | <p><i>nga të cilat angazhime</i></p> <p>Të plotësohet vetëm për linjat e kredisë.</p> |
| 080 | <p>Monedha</p> <p>E përcaktuar sipas ISO 4217</p> |
| 090 | <p>Funksionet kritike</p> <p>Të paraqitet shpërndarja e ekspozimeve sipas funksioneve kritike të identifikuara në formularin “Funksionet kritike” të Planeve të Rimëkëmbjes.</p> |
| 100 | <p>Veprimtaritë kryesore</p> <p>Të paraqitet shpërndarja e ekspozimeve sipas veprimtarive kryesore të identifikuara në formularin II “Veprimtaritë kryesore”.</p> |
| 110 | Informacion shtesë |

ANEKSI VI – Pjesëmarrja në infrastrukturën e tregjeve financiare (ITF)

Ky formular, përfshin elementët e trajtuar në nenin 26, paragrafi 1, shkronja “e”, të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, në zbatim të nenit 12 (9) ligjit nr. 133/2016, si më poshtë:

- çdo sistem nëpërmjet të cilit institucioni kryen një shumë ose një numër të rëndësishëm (material) transaksionesh, duke përfshirë shpërndarjen e tyre sipas subjekteve përbërëse, shërbimeve kritike dhe veprimtarive kryesore.
- çdo sistem pagese, klerimi dhe shlyerjeje, tek i cili subjekti është anëtar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke përfshirë shpërndarjen e tyre sipas subjekteve përbërëse, shërbimeve kritike dhe veprimtarive kryesore.

Udhëzime lidhur me kolonat specifike:

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| 010-020 | Subjekti juridik |
| 010 | Emri i subjektit Emri i subjektit që përdor shërbimet e pagesave, të kujdestarisë, të shlyerjeve, të klerimit, të tregtimit apo të depozitimit. |
| 020 | Kodi identifikues i subjektit Kodi LEI alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 010. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme” |
| 030-A80 | Karakteristikat e infrastrukturës së tregjeve financiare dhe ndërmjetësve që mundësojnë shërbime pagese, klerimi, netimi dhe kujdestarie |
| 030-060 | Sistemi |
| 030 | Lloji i sistemit Sistemet do të kategorizohen sipas listës më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Sistem pagesash – në shuma të mëdha (PS - LV); • Sisteme pagesash – me pakicë (PS – Retail); • Depozitari Qëndror i Titujve (CSD); • (CSD & Sistemi i shlyerjes së titujve (CSD-SSS); • Sistemi i shlyerjes së titujve pa kujdestari (SSS); • Kundërpartia qendrore për klerimin e derivativeve (CCP - derivativet); • Kundërpartia qendrore për klerimin e titujve (CCP – titujt); • Regjistrat e transaksioneve (të tregtimit) (TR). |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • lloje sistemesh që nuk përfshihen në listën e mësipërme • Shërbimet të ofruara nga një subjekt që nuk është pjesë e infrastrukturës së tregut, si p.sh., një bankë që ofron shërbimin e kujdestarisë. <p>Për rastet që përfshihen në më shumë se një kategori, jepni komentet në kolonën 140 “informacion shtesë”.</p> |
| 040 | <p>Përshkrimi</p> <p>Emri tregtar i Infrastrukturës së Tregjeve Financiare.</p> |
| 050 | <p>Mënyra e pjesëmarrjes</p> <p>Pjesëmarrje e drejtpërdrejtë në/anëtarësim në ITF; Pjesëmarrje e tërthortë në/anëtarësim në ITF. Zgjidhni kategorinë më të përshtatshme nga lista e kategorive.</p> |
| 060 | <p>Kodi identifikues</p> <p>Kodi LEI i ITF. Në mungesë të LEI, duhet të plotësohet me kodin BIC ose një kod identifikues lokal si p.sh. kodi i institucionit ose numri i llogarisë. Vetëm në rastet kur nuk ka një mënyrë tjetër identifikimi, lejohet të plotësohet me “i padisponueshëm”.</p> |
| 070-080 | <p>Institucioni përfaqësues</p> <p>Duhet të plotësohet vetëm për rastet kur pjesëmarrja konsiderohet “e tërthortë”, e trajtuar në kolonën 050. Nëse për të hyrë në ITF janë përdorur shumë banka korrespondente, duhet të raportohet në rreshta të ndarë për çdo bankë që mundëson hyrjen.</p> |
| 070 | <p>Emri i subjektit</p> <p>Institucioni i kredidhënies që i mundëson subjektit raportues hyrjen e tërthortë në ITF, sipas rastit. Institucioni përfaqësues mund të jetë pjesë e një grupi, pjesë e të cilit është edhe subjekti raportues; ky institucion mund edhe të jetë një subjekt tjetër kredidhënës që nuk është i lidhur me grupin.</p> <p>Institucioni përfaqësues përcaktohet nga Bordi i Stabilitetit Financiar-FSB si “ndërmjetësi ITF”. Një ndërmjetës ITF është një firmë që mundëson shërbime klerimi, pagesash, shlyerjeje titujsh dhe/ose shërbime kujdestarie për shoqëri të tjera. Ndërmjetësit ITF janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të një ose disa ITF dhe mundësojnë hyrje të tërthortë në shërbimet kritike të ofruara nga ITF (p.sh. në subjekte të tjera/ filiale të shoqërisë, ose në shoqëri që nuk janë filiale apo në klientë të tjerë).</p> |
| 080 | <p>Kodi identifikues i subjektit</p> <p>Kodi LEI alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 070. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion.</p> <p>Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të</p> |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| | plotësohet me “e padisponueshme”. |
| A10 | Operatori Subjekti juridik që operon sistemin (p.sh. STEP2 me operator EBA Clearing, TARGET 2 me Bundesbank apo me ndonjë bankë tjetër qëndrore si operator). |
| A20 | Shteti Legjislacioni i aplikueshëm ndaj rregullave të ITF dhe kontratave të anëtarësimit mes ITF dhe subjektit raportues për rastin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në ITF. Në rastin e pjesëmarrjes së tërthortë, duhet të plotësohet me legjislacionin e aplikueshëm për kontratat mes subjektit përfaqësues dhe subjektit raportues. Shteti duhet të identifikohet sipas kodit ISO 3166. |
| A40 | Shërbimet e mundësuara nga ITF / institucioni përfaqësues i subjektit raportues Një përshkrim i shkurtër me shkrim i shërbimeve të ofruara. |
| A70-A80 | Ofruesi i shërbimeve të hyrjes në ITF Ofruesit e përdorur nga banka, të cilat mundësojnë hyrjen në ITF |
| A70 | Ofruesi i shërbimeve të aksesit Specifikoni nëse ofruesi i hyrjes është zotëruesi i ITF apo tjetër. Gjithashtu, lutemi të specifikoni emrin e organizatës që mundëson shërbimin, p.sh. nëse po përdoret SIFT, raportoni “ të tjera (SIFT)”. |
| A80 | Tipi i shërbimeve të ofruara Lutemi specifikoni tipin e shërbimit të përdorur nga banka për të aksesuar ITF. Zgjidhni midis “sistemi i komunikimit”, “banka shlyerëse”, “korrespondenti në cash”, “ofruesi i likuiditetit” dhe “të tjera”. Nëse zgjidhet “Të tjera” lutemi të shtoni komente në kolonën 140 - “informacione shtesë”. |
| B40 | Numri i klientëve (‘000) Mesatarja ditore e numrit të klientëve, në mijë lek, gjatë vitit të kaluar. Nëse nuk sht e mundur, vendoset numri mesatar ditor, për një periudhë më të shkurtër. |
| B60 | Numri i transaksioneve (‘000) Mesatarja ditore e numrit të veprimeve të dërguara, në mijë lek, gjatë vitit të kaluar. Nëse nuk sht e mundur, vendoset numri mesatar ditor, për një periudhë më të shkurtër. |
| B80 | Vlera e transaksioneve (Mln LEK) Mesatarja ditore e vlerës së veprimeve të dërguara, në milionë LEK, gjatë vitit të kaluar. Nëse nuk sht e mundur, vendoset numri mesatar ditor, për një periudhë më të shkurtër. |

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| B100 | <p>Linja e kredisë (Mln LEK)</p> <p>Linja e kredisë e ofruar në sistem në rastin e aksesit të drejtpërdrejtë ose nga subjekti përfaqësues ose nga një ofruar tjetër likuiditeti në rastin e aksesit të tërthortë, e shprehur në milionë LEK. Ky rresht duhet plotësuar vetëm nëse është e aplikueshme, në të kundërt raportohet NA.</p> |
| B110 | <p>Niveli më i lartë i likuiditetit (ndërditor) ose i kërkesave për kolateral (Mln LEK)</p> <p>Ky rresht duhet të raportohet vetëm nëse është i aplikueshëm, në të kundërt (veçanërisht për rastet e rregjistrave të tregimit të derivativëve) plotësoni NA.</p> <p>Për Depozitarin Qëndror të Titujve ose për sistemet e pagesave në rastin e hyrjes të drejtpërdrejtë: niveli më i lartë (ndërditor) i përdorimit të kredisë.</p> <p>Për CCP-të dhe ITF që nuk mundësojnë asnjë kreditim për pjesëmarrësit e tyre, në rastin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë: niveli më i lartë i kërkesave për likuiditet (ndërditor) (psh marzhet e ndryshueshme në rastin e CCP-ve).</p> <p>Në rastin e hyrjes së tërthortë: niveli më i lartë i financimit të kërkuar nga institucioni përfaqësues.</p> <p>Të gjitha vlerat duhet të mundësohen në milionë LEK në përputhje me të dhënat historike që disponohen.</p> |
| 090-C30 | <p>Impakti i mundshëm në çështjet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme</p> |
| 090 | <p>Shpërndarja sipas funksioneve me rëndësi kritike</p> <p>Shpërndarja e funksioneve ekonomike do të përzgjidhet nga kategoritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pranimi i depozitave • Kredidhënie • Shërbimet e pagesave, shërbime me <i>cash-in</i>, të shlyerjes, klerimit dhe marrjes në kujdestari • Tregjet e kapitalit • Financimi në tregun ndërbankar. <p>Fusha plotësohet vetëm për rastet kur funksioni është identifikuar si kritik nga subjekti raportues në tregun lokal, sipas Formularit “Funksionet me rëndësi kritike”, të planit të rimëkëmbjes.</p> |
| 100 | <p>Shpërndarja sipas veprimtarive kryesore</p> <p>Ky raportim plotësohet vetëm nëse linja e biznesit është veprimtari kryesore për subjektin raportues (dhe është trajtuar si e tillë në Formularin III–“Veprimtaritë kryesore të biznesit” dhe aksesit tek shërbimet ITF ose tek shërbime të ngjashme të ofruara nga subjekti(et) përfaqësues është thelbësore për vazhdimësinë e asaj veprimtarie kryesore.</p> |
| C10 | <p>Sinjalet e ndërprerjes</p> <p>Dispozitat në marrëveshjet kontraktuale mes subjektit raportues dhe ITF, ose midis subjektit raportues dhe atij përfaqësues që mundëson hyrjen e</p> |

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|--|
| | <p>tërthortë në një ose disa ITF, të cilët lejojnë ndërprerjen e menjëhershme të shërbimit, në favor të ITF apo subjektit përfaqësues. Vlerat duhet të përzgjidhen nga lista e kategorive më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Asnjë • Përkeqësim në vlerësimin e rrezikut të kredisë (<i>rate-imit</i>) • Paaftësi paguese • Revokim i licences për veprimtari bankare • Ndërhyrje e hershme/ ristrukturim • Ndryshim i manaxhimit • Bashkimi/ Përthithja • Të tjera (specifiko). |
| 130 | <p>Zëvendësueshmëria</p> <p>Emri i ITF-ve të tjera ose subjekteve përfaqësues si dhe i zëvendësuesit të mundshëm të shërbimit të listuar në rreshtin 040.</p> |
| C20 | <p>Koha e zëvendësimit</p> <p>Koha e nevojshme për zëvendësimin (në ditë) në kushtet kur hyrja në ITF nuk është i mundur (për rastin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë) ose nëse aksesit tek subjekti përfaqësues nuk është i mundur (në rastin e pjesëmarrjes së tërthortë). Lutemi të vlerësoni kohën e nevojshme për ri-qarkullimin e transaksionit në një ITF tjetër, tek i cili banka është pjesëmarrëse ose tek një subjekt tjetër përfaqësues, ose vendosjen e aksesit (në një mënyrë të krahasueshme dhe me cilësi e kosto të arsyeshme) tek një ITF tjetër ose subjekt përfaqësues.</p> <p>Nëse ITF përdoret për segmente të ndryshme, raportoni kohën më të gjatë dhe specifikoni tek kolona 140 “informacion shtesë”, kohën që i korrespondon çdo segmenti. Përzgjidhni vlerat nga lista e kategorive si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ≤ 1 ditë; • 1 ditë-2 ditë; • 2 ditë- 1 javë; • >1 javë. |
| C30 | <p>Pika(t) e kontaktit në ITF/ subjektet përfaqësuese për çështje që lidhen me ndërhyrjen e jashtëzakonshme tek subjekti raportues</p> <p>Pika e kontaktit për subjektin raportues tek ITF. Zakonisht ky person është menaxher i marrëdhënieve. Përcaktoni: Emrin, Pozicionin/titulli, Numri i telefonit, adresa e-mail.</p> |
| 140 | <p>Informacion shtesë</p> |

ANEKSI VII — SISTEMET E INFORMACIONIT

Ky formular, përfshin elementët e trajtuar në nenin nenin 26, paragrafi 1, shkronja “F”, të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, në zbatim të nenit 12 (9) ligjit nr. 133/2016 , si më poshtë:

- një listë dhe përshkrim të detajuar të sistemeve kryesore të mbajtjes së informacionit, duke përfshirë edhe ato për administrimin e rrezikut, kontabilitetin dhe raportimin financiar dhe rregullator të subjektit, duke përfshirë shpërndarjen e subjekteve përbërëse, shërbimeve kritike dhe veprimtarive kryesore.
- identifikimin e zotëruesve të sistemeve të marrëveshjeve përkatëse të shërbimit si dhe të licencave të sistemeve dhe të programeve kompjuterike (softëëare-ve), duke përfshirë shpërndarjen e subjekteve përbërëse, shërbimeve kritike dhe veprimtarive kryesore.

Udhëzime lidhur me kolonat specifike:

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| 010-020 | Sistemi |
| 010 | Identifikimi Emri i sistemit / aplikacionit |
| 020 | Lloji Lloji i sistemit, të përzgjidhet nga kategoritë e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi bazë i bankës • Sistemi i thesarit • Administrim rreziku • Kontabiliteti • Raportimi financiar • Raportimi rregullator • Të tjera. |
| 030 | Përshkrimi Përshkrim i shkurtër i funksionaliteteve kryesore të sistemit. |
| 040-080 | Përdoruesi Informacion lidhur me subjektin që aktualisht po operon/ përdor sistemin/ aplikacionin. |
| 040 | Emri i subjektit |
| 050 | Kodi identifikues i subjektit Kodi alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 040. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e |

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|--|
| | padisponueshme”. |
| 060 | <p>Lloji i kontratës</p> <p>Këtu duhet të përcaktohet kontrata që rregullon përdorimin e sistemit në fjalë. Kur subjekti e zotëron/ka zhvilluar vetë sistemin, duhet të përzgjidhet kategoria “NA”. Për rastet kur sistemi/aplikacioni është licencuar nga një palë e tretë, duhet të përzgjidhet kategoria “licence”, ndërsa për rastet kur sistemi/aplikacioni është mundësuar nga një marrëveshje shërbimi me një subjekt tjetër të grupit (p.sh. rastin kur një filial përdor sistemin/aplikacionin e mundësuar nga mëma), duhet të zgjidhet kategoria “SLA”.</p> |
| 070 | <p>Funksionet me rëndësi kritike</p> <p>Nënkupton ‘funksionet me rëndësi kritike’ të përcaktuara në nenin 4(18) të Ligjit Nr. 133/2016. Sipas rastit, sistemi duhet të lidhet me një funksion me rëndësi kritike të përcaktuar në formularin “Funksionet me rëndësi kritike” në planin e rimëkëmbjes.</p> |
| 080 | <p>Veprimtaritë kryesore</p> <p>Nënkupton ‘veprimtari kryesore’ të përcaktuara në nenin 4(48) të Ligjit Nr. 133/2016. Sipas rastit, sistemi duhet të lidhet me një veprimtari kryesore të përcaktuar në Formularin II, “Veprimtaritë kryesore”.</p> |
| 090-100 | <p>Kundërpartia</p> <p>Kundërpartia e kontratës së nënshkruar për sistemin/aplikacionin. Ky rresht duhet të plotësohet vetëm kur “lloji i kontratës” në kolonën 060 është “licence” ose “SLA”, duke treguar palën e tretë ose subjektin e grupit që mundëson sistemin/ aplikacionin.</p> |
| 090 | <p>Emri i subjektit</p> <p>Emri i palës së tretë ose i subjektit të grupit që mundëson sistemin .</p> |
| 100 | <p>Kodi identifikues i subjektit</p> <p>Kodi LEI alfa-numerik prej 20 shifrash, i subjektit të identifikuar në kolonën 090. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion.</p> <p>Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”.</p> |
| 110-120 | <p>Marrëdhënia me të tretët</p> <p>Në rastet kur subjekti raportues përdor një sistem të mundësuar nga një shoqëri tjetër e grupit, këto kolona japin informacion lidhur me marrëdhënien kontraktuale të këtij subjekti të grupit. Kur subjekti i grupit zotëron/ ka zhvilluar vetë sistemin, nuk nevojitet asnjë informacion dhe duhet të plotësohet “NA” në fushën përkatëse. Kur subjekti i grupit e përdor sistemin sipas një licence të marrë nga një palë e tretë, duhet të listohet edhe</p> |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| | informacioni lidhur me këtë të fundit. |
| 110 | Emri i subjektit Emri i palës së tretë që ka ofruar licencën për sistemin/aplikacionin. |
| 120 | Kodi identifikues i subjektit Kodi alfa-numerik LEI prej 20 shifrash, i identifikuar në kolonën 110. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”. |
| 140-160 | Personi përgjegjës Këtu duhet të raportohet personi përgjegjës për sistemin në subjektin raportues. |
| 140 | Emri |
| 150 | Numri i telefonit |
| 160 | Adresa e e-mailit |

ANEKSI VIII, SEKSIONI 1 — NDËRLIDHJA FINANCIARE

Ky formular, përfshin elementët e trajtuar në nenin nenin 26, paragrafi 1, shkronja “g”, të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, në zbatim të nenit 12 (9) ligjit nr. 133/2016 , si më poshtë:

- *Identifikimin dhe shpërndarjen e subjekteve përbërëse dhe të ndërlidhjeve dhe ndërvarësive midis tyre si psh:*
 - *personeli, sistemet dhe objektet e përbashkëta;*
 - *kapitali, financimet dhe marrëveshjet e likuiditetit;*
 - *ekspozimet ekzistuese të kredisë dhe ato potenciale;*
 - *marrëveshjet e garancive të kryqëzuara, të kolateraleve të kryqëzuara, provigjionet e paafësisë paguese të përbashkët dhe marrëveshjet e netimit mes filialeve;*
 - *transferimi i rrezikut dhe marrëveshjet e mbulimit tregtar (back to back); marrëveshjet e shërbimeve*

Në “Seksionin 1” paraqiten marrëdhëniet financiare midis subjekteve të ndryshme të grupit në trajtën e aksioneve, financimet/thesari, garancitë, angazhimet, kredi të ndryshme, e të tjera. Ky formular përfshin vetëm ndërlidhjet financiare. Llojet e tjera të ndërlidhjeve, të specifikuara më sipër, mundësohen në formularë të veçantë.

Udhëzime lidhur me kolonat specifike:

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| 010-020 | Subjekti juridik A |
| 010 | Emri i subjektit Duhet të jetë i ndryshëm nga emri i listuar në kolonën 030. |
| 020 | Kodi identifikues i subjektit Kodi alfa-numerik LEI prej 20 shifrash, për subjektin e identifikuar në kolonën 010. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Duhet të jetë i ndryshëm nga kodi i përfshirë në kolonën 040 Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”. |
| 030-040 | Subjekti juridik B |
| 030 | Emri i subjektit Duhet të jetë i ndryshëm nga emri i listuar në kolonën 010. |
| 040 | Kodi identifikues i subjektit Kodi alfa-numerik LEI prej 20 shifrash, për subjektin e identifikuar në kolonën 030. Kodi LEI identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| | <p>çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion.</p> <p>Duhet të jetë i ndryshëm nga kodi i përfshirë në kolonën 020</p> <p>Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”.</p> |
| 050 | <p>Lloji i ndërlidhjes</p> <p>Të përzgjidhet nga kategoritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aksione • Thesari / Financimet (përfshi Rezervat e likuiditetit) • Garancitë • Angazhimet • Kredi (të ndryshme nga Thesari / Financimet) • Të tjera (përcakto) |
| 060 | <p>Monedha</p> <p>Sipas përcaktimit të ISO 4217</p> |
| 070 | <p>Shuma (në milionë)</p> <p>Plotëso vlerën e produktit të listuar në kolonën 050 në datën e raportimit, në milionë lek.</p> |

ANEKSI VIII, SEKSIONI 2 — SHËRBIMET E PËRBASHKËTA (BAZË)

Ky formular, përfshin elementët e trajtuar në nenin 26, paragrafi 1, shkronja “g”, të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, në zbatim të nenit 12 (9) ligjit nr. 133/2016 , si më poshtë:

- *Identifikimin dhe shpërndarjen e subjekteve përbërëse dhe të ndërlidhjeve dhe ndërvarësive midis tyre si psh:*
 - *personeli, sistemet dhe objektet e përbashkëta;*
 - *kapitali, financimet dhe marrëveshjet e likuiditetit;*
 - *ekspozimet ekzistuese të kredisë dhe ato potenciale;*
 - *marrëveshjet e garancive të kryqëzuara, të kolateraleve të kryqëzuara, provigjionet e paaftësisë paguese të përbashkët dhe marrëveshjet e netimit mes filialeve;*
 - *transferimi i rrezikut dhe marrëveshjet e mbulimit tregtar (back to back); marrëveshjet e shërbimeve*

Në “Seksionin 2” paraqiten ndërlidhjet midis subjekteve të ndryshme të grupit që përdorin shërbimet e përbashkëta që lidhen me kontabilitetin, kontrollin, thesarin/ ALM, rrezikun, përputhshmërinë, shërbimet ligjore, pagesat, sigurinë, pasuritë e paluajtshme, burimet njerëzore, e të tjera. Ky formular përfshin vetëm shërbimet e përbashkëta. Llojet e tjera të ndërlidhjeve, mundësohen në formularë të veçantë.

Udhëzime lidhur me kolonat specifike:

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| 010-020 | Ofruesi i shërbimit Informacion lidhur me (Grupin) subjektin që ofron shërbimin. |
| 010 | Emri i subjektit Duhet të jetë i ndryshëm nga ai i listuar në kolonën 030. |
| 020 | Kodi identifikues i subjektit Kodi alfa-numerik prej 20 shifrash, për subjektin e identifikuar në kolonën 010. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Duhet të jetë i ndryshëm nga kodi i përfshirë në kolonën 040 Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”. |
| 030-040 | Përfituesi i shërbimit Informacion lidhur me (Grupin) subjektin që përfiton shërbimin. |
| 030 | Emri i subjektit Duhet të jetë i ndryshëm nga ai i listuar në kolonën 010. |
| 040 | Kodi identifikues i subjektit Kodi alfa-numerik LEI prej 20 shifrash, për subjektin e identifikuar në |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|--|
| | <p>kolonën 030. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion.</p> <p>Duhet të jetë i ndryshëm nga kodi i përfshirë në kolonën 020</p> <p>Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”.</p> |
| 050-070 | <p>Shërbimi</p> <p>Informacion lidhur me shërbimin e përbashkët.</p> |
| 050 | <p>Kategoria</p> <p>Shërbimi i përbashkët ndahet sipas kategorive më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontabiliteti • Kontrolli • Thesari/ ALM • Rreziku • Përputhshmëria • Ligjori • Pagesat • Siguria • Pasuritë e paluajtshme • Burimet Njerëzore • Të tjera |
| 060 | <p>Përshkrimi</p> <p>Përshkrimi i shërbimit të ofruar</p> |
| 070 | <p>Funksioni me rëndësi kritike</p> <p>Shpërndarja e shërbimit të përbashkët me funksionet me rëndësi kritike sipas përcaktimit të formularit “Funksionet me rëndësi kritike” në formularët raportimit të planit të rimëkëmbjes. Në rastet kur shërbimi nuk mund të lidhet me një funksion, por është i rëndësishëm për subjektin (p.sh. mundësia e raportimit periodik për kapitalin rregullator), në këtë kolonë duhet plotësuar “subjekti”.</p> |
| 080-090 | <p>Marrëveshjet kontraktuale</p> <p>Informacion lidhur me marrëveshjet kontraktuale që rregullojnë shërbimin</p> |
| 080 | <p>Marrëveshjet e shërbimit që janë në fuqi</p> <p>Përzgjidhni “po” ose “jo” nga menu-ja për të treguar nëse shërbimet janë të mbuluara me një marrëveshje shërbimi mes ofruesit të shërbimit dhe palës përfituese.</p> |
| 090 | <p>Kontratat e mbrojtura nga ndërhyrja e jashtëzakonshme</p> <p>Përzgjidhni “po” (kontrata vlerësohet e mbrojtur nga ndërhyrja e</p> |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| | jashtëzakonshme ose “jo” (kontrata vlerësohet jo e mbrojtur nga ndërhyrja e jashtëzakonshme) nga menu-ja për të treguar nëse termat e marrëveshjes përfshijnë një klauzolë ku specifikohet se ndërmarrja e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme tek palët, mund të jetë një nxitës për ndërprerjen e kontratës. |
| 100 | <p>Komente</p> <p>Përfshini çdo informacion shtesë, të nevojshëm për vlerësimin e shërbimeve të përbashkëta (p.sh. përcaktoni çfarë nënkuptohet nëse zgjidhni “të tjera” në kolonën 050 ose qartësoni më tej shpërndarjen e shërbimeve sipas funksioneve kritike).</p> |

ANEKSI IX – MARRËVESHJET KONTRAKTUALE

Ky formular, përfshin elementët e trajtuar në nenin nenin 26, paragrafi 1, shkronja “h”, të rregullores “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, në zbatim të nenit 12 (9) ligjit nr. 133/2016, si më poshtë:

- *të gjitha marrëveshjet e subjektit dhe njërive përbërëse me palë të treta, ndërprerja e të cilave mund të nxitet nga një vendim i autoriteteve për të ndërmarrë veprime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe ku pasojat e ndërprerjes mund të ndikojnë në zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme*

Ndërsa rregullorja përcakton “të gjitha marrëveshjet”, bankave u sugjerohet të zhvillojnë një metodologji për të përcaktuar kontratat “relevante” me palë të treta, p.sh. të përcaktojnë kufij materialë që marrin parasysh përmasat e kontratës, nëse një kontratë është e lidhur me një funksion me rëndësi kritike, etj.

Udhëzime lidhur me kolonat specifike:

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|---|
| 010-020 | Subjekti juridik |
| 010 | Emri i subjektit |
| 020 | Kodi identifikues i subjektit Kodi alfa-numerik LEI prej 20 shifrash, për subjektin e identifikuar në kolonën 010. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”. |
| 030-040 | Pala e tretë |
| 030 | Emri i subjektit |
| 040 | Kodi identifikues i subjektit Kodi alfa-numerik LEI prej 20 shifrash, për subjektin e identifikuar në kolonën 030. Kodi identifikues i subjektit identifikon në mënyrë unike çdo subjekt ligjor ose strukturë që është pjesë e një transaksioni, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” LEI nuk është i vlefshëm për një subjekt të caktuar juridik, duhet të mundësohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur edhe kjo është e pamundur, lejohet të plotësohet me “e padisponueshme”. |
| 050 | Lloji i kontratës |
| 060 | Kontratat e mbrojtura nga ndërhyrja e jashtëzakonshme Në këtë fushë përcaktohet nëse ndërhyrja e jashtëzakonshme mund të nxisë |

BANKA E SHQIPËRISË - Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme

| Kolonat | Referenca ligjore dhe udhëzimi |
|---------|--|
| | përfundimin e një kontrate me palë të treta. Përzgjidhni “po” ose “jo” nga lista e kategorive. |
| 070 | Komente Jepni një shpjegim të vlerësimit tuaj në kolonën 070. |